



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE FISKALE  
DHE TE ARDHURAVE PUBLIKE**

Nr. 10672/4 Prot.

Tiranë, më 18.11.2014

**URDHËR**

Nr. 90, datë 18.11.14

**PËR**

**MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS”  
NË SHËRBIMIN DOGANOR SHQIPTAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në cilësinë e ministrit përgjegjës, të institucionit “Drejtorja e Përgjithshme e Doganave”:

**URDHËROJ**

1. Miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, të marrë masë e nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të Kodit të Etikës, në të gjithë administratën doganore.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





## KODI I ETIKËS NË SHËRBIMIN DOGANOR SHQIPTAR

### **Përcaktime:**

Për qëllime të këtij akti, Rregullat e Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar do të konsiderohen si tërësia e normave etike në Shërbimin Doganor dhe do të përkufizohen si Kodi i Etikës, e do të përdoret si i tillë në këtë akt.

### **Objekti:**

Qëllimi i Kodit të Etikës është përcaktimi i rregullave të sjelljes, që punonjësit e Administratës Doganore duhet të zbatojnë detyrimisht dhe në shkallën më të lartë.

Për të siguruar besimin publik në integritetin e Doganave, të gjithë punonjësit e Doganave Shqiptare duhet të respektojnë dhe t'i përmbahen rregullave të Kodit të Etikës.

### **Përmbajtja:**

Të gjithë punonjësit e Administratës Doganore duhet të jenë të ndershëm, të paanshëm dhe kompetentë. Me qëllim që të fitohet dhe të ruhet besimi i publikut kur kontaktohet me të, me mjediset tregtare ose me punonjësit e tjerë të Administratës Shtetërore, punonjësi i Administratës Doganore duhet të respektojë në mënyrë rigoroz rregullat e Kodit të Etikës.

Rregullat e Kodit të Etikës përcaktojnë konkretisht rregullat në fushën e sjelljes, që duhet të zbatohen detyrimisht nga të gjithë punonjësit e Administratës Doganore.

Këto rregulla të etikës udhëzojnë mbi mënyrën e zgjidhjes së problemeve të etikës për ata që kanë lidhje me Administratën Doganore dhe që kanë të bëjnë me punonjësit e doganave.

### **Elementet thelbësore të rregullave të Kodit të Etikës:**

1. Përgjegjësia Personale;
2. Respektimi i Ligjit;
3. Marrëdhëniet me Publikun;
4. Vënia e kufijve në pranimin e dhuratave, shpërblimeve, si dhe ftesave të ndryshme;
5. Shmangia e konfliktit të interesave;
6. Aktivitete me karakter publik;

7. Vënia e kufijve për veprimtaritë politike;
8. Sjellje që përfshijnë çështje monetare;
9. Përdorimi i Informacioneve konfidenciale/Sekreti Profesional;
10. Përdorimi i pronave dhe shërbimeve shtetërore;
11. Blerja për qëllime private i objekteve që i përkasin shtetit nga ana e punonjësve;
12. Ambjenti i punës.

Secili nga këto elementë përshkruhet në mënyrë të detajuar më poshtë:

## **1 Përgjegjësia Personale**

### **1.1. Rregulla të përgjithshme**

Punonjësit e Administratës Doganore duhet të pranojnë përgjegjësinë personale në lidhje me respektimin e Kodit të Etikës dhe në veçanti:

- Të kryejnë detyrën e tyre me ndershmëri, kujdes, përkushtim, integritet dhe paanësi;
- të synojnë për arritjen e standarteve më të larta të etikës në mënyrë që të fitojnë besimin e publikut që shërbejnë dhe të mos mjaftohen me zbatimin minimal të normave që përcaktohen në dispozitat ligjore ose nga zbatimi i procedurave në fuqi;
- të lexojnë dhe të kuptojnë rregullat e Kodit të Etikës, si dhe pasojat në rastet e moszbatimit;
- të mos përfshihen në interesa financiare që bien në konflikt me performancën në punë;
- të mos përfshihen në manovra financiare duke përdorur informacione qeveritare jo-publike ose duke lejuar përdorimin e këtij informacioni për interesa personale;
- të mos pranojnë, përveç rasteve të parashikuara në Kodin e Etikës, asnjë dhuratë ose objekt tjetër me vlerë monetare nga persona apo subjekte që kërkojnë privilegje nga ushtrimi ose mosushtrimi i detyrës nga punonjësi i Administratës Doganore;
- të trajtojnë kolegët dhe publikun me profesionalizëm dhe mirësjellje;
- të evitojnë sjelljet preferenciale për subjekte apo individë të ndryshëm;
- të evitojnë keqpërdorimin e burimeve publike, si dhe t'i ruajnë ato nga përdorimi i paautorizuar;
- të mospërdorin zyrat për përfitime personale;

- të mos angazhohet në aktivitete të tjera që përfshijnë kërkimin ose negociimin për punë, që konfliktin me punën dhe përgjegjësitë shtetërore;
- të mos zbulojnë ose përdorin informacione jo-publike gjatë kohës së punësimit të tyre për përfitime personale ose për të tjerë;
- të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe përmirësojnë imazhin dhe statusin e Administratës Doganore.

## **2. Respektimi i Ligjit**

### **2.1. Vepra Penale**

Të gjithë nëpunësit e Administratës Doganore duhet të respektojnë ligjin.

Për vetë përgjegjësitë e veçanta që ka dogana shqiptare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë kur nga vetë punonjësit e Administratës Doganore shkelen ligjet që rregullojnë punën e doganave shqiptare ose që kanë lidhje me të dhe për të cilat janë ngarkuar t'i zbatojnë.

Për nëpunësit e Administratës Doganore që kryejnë shkelje që kanë lidhje në veçanti me drogat e ndaluara, me kontrabandën, me korrupsionin, me eksportin dhe importin e mallrave në mënyrë të paligjshme, merren masa disiplinore dhe/ose të shoqëruara me sanksione që zbatohen në vijim të procedimit penal.

Të gjithë punonjësit e Administratës Doganore janë të detyruar të njoftojnë eprorët e tyre, kur ndaj tyre ka filluar ose janë njoftuar se mund të fillojë një procedim penal. Me marrjen e këtij informacioni veprohet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për nëpunësin civil.

Me fillimin e marrëdhënieve të punës, punonjësit për të mbështetur vetëdeklarimin duhet të paraqesin vërtetime nga gjykata, prokuroria dhe formularin e dëshmisë së penaltetit së bashku me formularin e deklarimit të pasurisë dhe autorizimin bazuar në pikën 2, të nenit 41, të ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Asnjë veprim zyrtar nuk duhet të ndërmerret nga ana e punonjësit për të penguar veprimtarinë hetimore.

### **2.2 Ankesat ndaj Doganave dhe punonjësve të saj**

Është e rëndësishme që publiku të jetë i bindur për transparencën dhe ndershmërinë e punonjësve të Administratës Doganore. Për të siguruar, si dhe për të ruajtur këtë bindje, kur ka ankesa kundrejt doganave dhe/ose ndaj punonjësve të veçantë të saj, duhet të ndërmerret një hetim i menjëhershëm dhe objektiv.

### **2.3. Veprime që kanë lidhje me punonjësit e Administratës Doganore**

Punonjësit e doganave duhet t'i raportojnë eprorit të tyre ose të raportojnë në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit apo Drejtorinë e Hetimit kur vlerësojnë se i është kërkuar të veprojnë në mënyrë të paligjshme, të pandershme dhe në kundërshtim me etikën profesionale, të shtyrë nga një koleg ose një epror.

Eprorët ose Drejtoria e Hetimit duhet të marrin në konsideratë këto ankesa dhe të marrin masa për të hetuar rreth tyre. Në rastet kur eprorë të lartë të Administratës Doganore rezultojnë të inkrimnuar, mund të gjykohet e nevojshme që hetimi t'i besohet institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj jashtë Administratës Doganore.

## **3. Informimi dhe Mosdiskriminimi**

Punonjësit e Administratës Doganore duhet të sillen në mënyrë korrekte, kompetente, të sjellshme, profesionale gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe informimit të publikut. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së informacionit me karakter konfidencial.

Personeli i Administratës Doganore nuk duhet të përfshihet në praktika diskriminuese me bazë race, kombësie, gjinie, feje, moshe, orientimi seksual, paaftësie fizike apo çdo lloj praktike tjetër diskriminuese.

### **3.1. Paanshmëria**

Ka shumë rëndësi që punonjësi i Administratës Doganore, në komunikimin me publikun të jetë i paanshëm duke mos privilegjuar asnjë palë. Punonjësit e doganave nuk duhet të përdorin vendin e tyre të punës për të favorizuar aktivitetin e tyre personal ose të dikujt tjetër. Nëse punonjësi i doganave ka paqartësi në lidhje me procedurat ai duhet t'i drejtohet eprorit.

### **3.2. Paraqitja e emrit dhe dokumentit identifikues**

Në pjesën më të madhe të rasteve publiku ka të drejtën të njohë emrin e punonjësit të doganave me të cilin ka të bëjë. Të gjithë punonjësit e doganave janë të detyruar të prezantojnë emrin e tyre, si në korrespondenca, ashtu edhe në telefon, ndërsa punonjësit e doganave që kanë kontakt me publikun gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhet të mbajnë në mënyrë të ekspozuar dokumentin identifikues. Bëhet përjashtim nga ky rregull kur mbajtja e këtij dokumenti çënon sigurinë e punonjësit ose kompromenton një operacion të fshehtë.

### **3.3. Siguria - Agresioni ndaj një punonjësi të Administratës Doganore**

Punonjësit e doganave, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, duhet të mendojnë fillimisht për sigurinë personale dhe të kolegëve të tyre. Kur gjykojnë se nuk duhet të ndërhyjnë vetë, duhet të kërkojnë përforcime nga organet e specializuara. Në këto raste kërkesa për ndërhyrje duhet t'i njoftohet eprorit më të afërt.

### **3.4. Marrëdhëniet me Komunitetin e Biznesit**

Subjektet duhet të kenë akses në standardet e etikës që zbatojnë doganat dhe të kujdesen që në praktikën që ata kryejnë të mos detyrojnë punonjësit t'i shkelin këto standarde. Në rastet kur një subjekt tenton të përfitojë masa favorizuese ose një trajtim special në këmbim të një shpërblimi kundrejt punonjësit të doganave, ky i fundit duhet të raportojë menjëherë me shkrim tek eprori ose Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, apo Drejtoria e Hetimit.

## **4. Vënia e kufijve në pranimin e dhuratave, shpërblimeve si dhe ftesave të ndryshme**

### **4.1. Dhuratat dhe Ftesat**

Është e rëndësishme të mbahen kontakte bashkëpunimi me sektorin privat, por është parësore që punonjësi i doganave të jetë i pakorruptueshëm. Çdo dhuratë, ftesë ose shpërblim mund të konsiderohet si mjet për të influencuar mbi vendimin që duhet të marrë punonjësi i Administratës Doganore, prandaj duhet evituar.

Pranimi i dhuratave rregullohet në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar".

Në raste të tjera që nuk janë të parashikuara më lart, punonjësi i doganave nuk duhet të pranojë as dhurata dhe as ftesa.

### **4.2. Punonjësit e sistemit doganor të përfshirë në blerje**

Punonjësit e ngarkuar me blerje duhet të kujdesen në veçanti që të mos akuzohen për praktika të parregullta në këtë fushë. Punonjësi në asnjë rast nuk duhet të pranojë dhurata ose ftesa nga ana e furnitorëve aktual ose të ardhshëm.

### **4.3. Avantazhe rastësore të përftuara në vijim të blerjes me fonde shtetërore të mallrave ose shërbimeve**

Shumë subjekte ofrojnë dhurata kujtdo që përdor shërbimet e tyre. I tillë është rasti i operacioneve që kanë për qëllim të shpërblejnë besnikërinë e punonjësit dhe që i lejon klientit të grumbullojë pikë në varësi të produkteve të blera ose shërbimeve të përdorura.

Administrata Doganore mund të jetë përftuese e këtyre avantazheve, ndërsa punonjësi doganor personalisht nuk duhet dhe nuk mund të përfitojë.

### **4.4. Oferta për udhëtime falas për qëllime zyrtare**

Në rastet ku disa kompani transporti ajror, detar apo tokësor, vënë në dispozicion falas shërbimet e tyre për punonjësit e doganave për udhëtime zyrtare, ato nuk duhet të pranohen,

me qëllim shmangien e dyshimeve për përfshirjen e Administratës Doganore në marrëdhënie jo të rregullta dhe në konflikt interesi me atë kompani që jep këto lloj ofertash.

#### **4.5. Mospranimi i favoreve të tjera**

Konsiderohet shkelje e Kodit të Etikës pranimi i përfitimeve nga ana e punonjësve të doganës, të cilat konsistojnë në ulje të çmimit të mallrave ose shërbimeve që tregëtohen nga subjektet tregtare, të cilat kanë marrëdhënie zyrtare me autoritetet doganore.

### **5. Shmangia e Konfliktit të interesave**

#### **5.1. Marrëdhënie personale me këdo që ka lidhje me Doganat**

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” të ndryshuar” dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo punonjës i administratës doganore me qëllim parandalimin dhe/ose deklarimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Mundësia për shfaqjen e konfliktit të interesave ekziston atëherë kur punonjësi i doganave ka interesa privatë në kuptim të ligjit të sipërcituar.

#### **5.2. Aksionet**

Punonjësit e doganave kanë të drejtë të blejnë aksione ose pasuri në përputhje me kushtëzimet e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, të ndryshuar”. Megjithatë, punonjësi nuk duhet të marrë pjesë direkt ose indirekt si përfaqësues zyrtar në një vendim që influencon ose mund të influencojë, për shkak të lidhjeve apo interesave që mund të ketë ky punonjës, mbi këto aksione ose pasuri. Këto interesa financiare të vetë punonjësit apo të personave të lidhur me të, duhet të jenë një kusht i mjaftueshëm për ta përjashtuar atë nga një proces i tillë vendimmarrje. Gjithashtu, punonjësi nuk duhet të përdorë në favor të tij ose të të tretëve informacione të përftuara gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Në qoftë se punonjësi vlerëson se mund të ketë konflikt interesash ai duhet të informojë me shkrim Eprorin direkt, Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ose Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, apo Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave.

#### **5.3. Përfshirja në Interesa Biznesi dhe Kontrata Shtetërore**

Asnjë kontratë shtetërore nuk duhet t’i jepet asnjë punonjësi të Administratës Doganore ose një partneritet ku pjesëmarrës mund të jetë një punonjës i doganave.

#### **5.4. Dypunësimi**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi punonjësi duhet të marrë miratimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për punësim me kohë të pjesshme në fushën e

mësimdhënies. Dypunësimi nuk duhet të shkaktojë konflikt interesash dhe nuk duhet të pengojë kryerjen e detyrës.

## **6. Aktivitete me karakter publik**

Punonjësit e Administratës Doganore nuk duhet të bëjnë në publik komente të papërshtatshme mbi politikat dhe programet e Administratës Doganore si:

- Vërejtje mbi politikat ose programe të Administratës Doganore që punonjësi ka qenë i ngarkuar t'i hartojë ose t'i zbatojë;
- Deklaratat dhe opinionet personale (jo zyrtare) që mund të interpretohen si zyrtare;
- Sulme në drejtim të Administratës Doganore që mund të çenojnë aktivitetin e saj;
- Kritika për politikën e Administratës Doganore në fushën e funksioneve zyrtare të përfaqësimit;
- Sulme personale në drejtim të kolegëve të Administratës Doganore;

## **7. Vënia e kufijve për veprimtaritë politike**

**7.1** Me qëllim që të mos çënohen marrëdhëniet mes punonjësit të doganave dhe publikut, i gjithë personeli doganor ndalohet të bëjë gjatë orarit të punës propagandë politike.

**7.2** Punonjësve të doganave u ndalohet:

- Mbajtja gjatë orarit të punës së shenjave të partive ose shoqatave politike;
- Shpërndarja e materialeve propagandistike në të gjitha ambjentet e punës;
- Përdorimi i mjediseve të punës për zhvillimin e aktiviteteve politike;
- Diskutimi gjatë orarit të punës për çështje politike;
- Pjesëmarrja me uniformë ose civil në manifestime të paautorizuara nga organet kompetente.

## **8. Sjellje që përfshijnë çështje monetare**

### **8.1 Rregulla të Përgjithshme**

Punonjësi i Administratës Doganore duhet të informojë menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave kur gjendet në vështirësi financiare. Kjo është e vlefshme gjithashtu edhe për

punonjësit që gjenden në vështirësi të mëdha financiare dhe nuk kanë mundësi të përballojnë borxhet e tyre.

Punonjësi që ka vështirësi të mëdha financiare lejohet të ruajë vendin e punës, me përjashtim të rasteve kur ka kryer një shkelje të rëndë duke prekur fondet publike, veprim për të cilin dënohet me sanksione disiplinore ose penale. Punonjësi që ka vështirësi financiare nuk duhet të vendoset në poste ku ekziston eventualisht mundësia të abuzojë me fondet publike.

## **8.2 Operacionet financiare me karakter privat**

Nuk u këshillohet punonjësve të Administratës Doganore të kryejnë operacione financiare me karakter privat mes tyre. Ky rekomandim vlen gjithashtu për dhënien e huave një kolegu ose garantimin e një huamarrjeje.

Punonjësit që kryejnë operacione të kësaj natyre me kolegët e tjerë të personelit doganor duhet të marrin përgjegjësi personale. Punonjësit duhet të kujdesen që këto veprime/operacione të mos dëmtojnë veprimtarinë dhe reputacionin e doganës.

## **8.3 Fonde që i përkasin Administratës Doganore**

Arkëtimin e fondeve që i përkasin Administratës Doganore mund ta bëjnë vetëm punonjësit e doganës që në ushtrimin e funksioneve të tyre, janë ngarkuar për të kryer arkëtimet. Asnjë punonjës nuk duhet të arkëtojë fonde që i përkasin Administratës Doganore pa qenë i autorizuar për të ndërmarrë këtë detyrë. Autorizimi duhet të jetë i konfirmuar me shkrim.

Të gjitha pagesat e pranuar për llogari të doganës duhet të regjistrohen menjëherë sipas rregullave dhe udhëzimeve të dhëna për këtë qëllim.

Të gjithë punonjësit janë të detyruar të përdorin fondet publike vetëm për destinacionin që janë përcaktuar, si dhe të kujdesen që këto fonde të përdoren në mënyrë të drejtë. Ata duhet të evitojnë që askush të mos mendojë se këto fonde përdoren nga vetë punonjësit e doganës. Gjithashtu të gjitha fondet duhet të destinohen për t'iu përgjigjur nevojave të ligjshme të doganës.

Nëse përdorimi i fondeve publike i krijon avantazhe të tërthorta ndonjë punonjësi ai duhet të jetë në gjendje të justifikohet, nëse kritikohet nga shtypi ose publiku. Është e papranueshme që një shpërblim dhënë një punonjësi të konsiderohet si një avantazh në natyrë.

Për sa i përket fondeve publike zbatohen rregullat e mëposhtme:

- fondet publike duhet të përdoren sipas ligjit dhe në mënyrën e duhur;
- veprimet me fondet publike duhet të kontabilizohen me korrektësi;
- vetëm personat e autorizuar mund të marrin vendime në fushën e shpenzimeve;
- rregullat që zbatohen për pranimin e dhuratave dhe ftesave, si dhe për avantazhet e tjera, janë të vlefshme dhe për personelin që merr vendime në fushën e shpenzimeve;

- nëpunësit nuk duhet të nxjerrin përfitime, as për vete, as për të tretë, duke shfrytëzuar statusin e tyre.

## **9. Përdorimi i Informacioneve konfidenciale/Sekreti profesional**

Të gjithë punonjësit e doganës janë të detyruar të mos bëjnë publike informacione që kanë marrë gjatë ushtrimit të detyrës. Ky rregull zbatohet gjithashtu për të gjithë dokumentet, dosjet dhe informacionet e paraqitura në formë elektronike. Ata janë të detyruar të ruajnë këto informacione me karakter konfidencial mbi personat me të cilët kanë marrëdhënie në kuadrin e veprimtarisë profesionale. Abuzimet në këtë fushë mund të jenë:

- Shpërndarja e këtyre informacioneve;
- Shfrytëzimi i këtyre informacioneve për qëllime personale;
- Përdorimi i informacioneve të dosjeve personale me qëllim që të përftohen avantazhe nga një person i caktuar;
- Marrja, modifikimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare;

Ndalohet dhënia pa autorizim të tretëve, qofshin këto punonjës të Administratës Doganore e të dhënave mbi zhdoganimet, dosjet dhe librat kontabël, kontrollet, si dhe dhënia e kopjeve të akteve të ndryshme me përjashtim të rasteve kur me akte ligjore e nënligjore është parashikuar ndryshe.

Ndalohet gjithashtu dhënia e informacioneve të tretëve mbi gjendjen e brendshme të shërbimit doganor ose mbi jetën private të punonjësve të doganës, si dhe diskutimet mbi temat e sipërpërmendura në ambiente publike.

Punonjësit e doganës, që nxjerrin sekretin profesional, dënohen administrativisht dhe në varësi të rrethanave mund të kallëzohen dhe penalisht.

## **10. Përdorimi i pronave dhe shërbimeve shtetërore**

### **10.1. Rregulla të Përgjithshme**

Është i ndaluar përdorimi për qëllime personale ose përfitim personal i objekteve që i përkasin doganës ose i shërbimeve të saj, që financohen nga fonde publike. Bëhet fjalë për objektet ose shërbimet e mëposhtme:

- Telefona, fotokopje, materiale kancelerie, skanera, printera;
- Automjete, anije, makineri dhe aparatura të ndryshme;
- Kompjuteri;

Shpenzimet për objektet dhe shërbimet mund të reduktohen duke i kushtuar një vëmendje të veçantë administrimit të tyre, si dhe pasurive të tjera të doganës. Të gjithë punonjësit e doganës janë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pasurinë e doganës për të cilën janë përgjegjës.

## **10.2 Automjetet**

Rregulla të veçanta zbatohen në përdorimin e automjeteve të punës, si dhe për trajtimin e tyre. Këto rregulla janë si vijon:

- Punonjësit që drejtojnë automjetet e punës, duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi, si dhe të kenë një autorizim për t'i përdorur, lëshuar nga struktura përkatëse;
- Punonjësit e doganës nuk duhet të drejtojnë automjetet e punës, kur sjellja e tyre nuk është korrekte si pasojë e konsumit të alkoolit;
- Automjetet e punës nuk duhet të përdoren për vajtje-ardhje nga banesa personale në ambientin e punës me përjashtim të rasteve, kur ka një autorizim special.

## **10.3 Identifikimi zyrtar**

Dokumenti i identitetit u jepet punonjësve të doganës për të lehtësuar identifikimin e tyre kur ata përmbushin detyrat, si dhe u lejon atyre të ushtrojnë kompetencat që kanë. Ato nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera. Dokumenti i identitetit, çelësat, fjalë-kalimet duhet të ruhen me shumë kujdes nga punonjësit që i disponojnë, si dhe t'i dorëzohen doganës kur personi largohet.

## **11. Blerja për qëllime private i objekteve që i përkasin shtetit nga ana e punonjësve**

### **11.1 Blerje nga personeli i doganës i të mirave materiale që i përkasin shtetit**

Çdo punonjës mund të blejë të mira materiale që i përkasin shtetit kur ato i shiten publikut (botime, furnizime të tepërta, mallra të shitura nga shteti) me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- Ai është vënë në dijeni të gjendjes në të cilën ndodhen mallrat e shitura për shkak të postit që ai mban;
- Ai ka marrë pjesë në kuadrin e ushtrimit të funksionit të tij në vendosjen e masave ndaj këtyre mallrave në fjalë;
- Ai mund të përftojë zbritje në këto mallra, në një kohë që një person tjetër jo i doganës, nuk mund të ketë përfitime të tilla;

## **11.2. Blerja e mallrave të sekuestruara nga Doganat**

Punonjësit e doganës nuk duhet të konsiderohen të favorizuar kundrejt të tjerëve, kur blihen mallra të konfiskuara ose të sekuestruara. Atyre u ndalohet të blejnë vetë ose me anë të të tretëve mallra në shitje që organizon dogana.

Gjithashtu nuk autorizohen për blerjen e mallrave punonjësit që janë ngarkuar për të marrë të gjitha masat për shitjen e mallrave në fjalë ose që falë funksioneve të tyre posedojnë informacione të veçanta mbi këto mallra.

## **12. Ambjenti i punës**

### **12.1. Rregulla të Përgjithshme**

Të gjithë punonjësit kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në kushte sa më të mira shëndeti dhe sigurie, pa qenë objekt i diskriminimit dhe në një ambient ku objektivat e caktuara gjithsecilit nga Administrata Doganore mund të arrihen. Një ambient profesional mund të gjykohet:

- Kur ai është i drejtë dhe i përshtatshëm;
- Kur është i sigurt dhe i jep mbështetje punonjësit të doganës;
- Kur nuk konsumohet alkool;
- Kur nuk ka diskriminim ose dhunim të individit;
- Kur konsiderohen si vlerë ndryshimet midis individëve dhe diversitetit të kulturave;
- Kur informon në mënyrë të paanshme punonjësit për rezultatet e tyre dhe i lejon të përmirësohen;
- Kur përpiqet të tërheqë pjesëmarrjen e personelit në procesin e vendimmarrjes;

### **12.2. Kujdesi në mënyrë aktive**

Është parësore që çdo punonjës i doganës të angazhohet në mënyrë aktive që në ambientet e punës të veprohet në mënyrë korrekte dhe pa bërë diskriminime duke garantuar barazinë, zbatimin e rregullave të etikës dhe parimin e ndjenjës së përgjegjësisë.

### **12.3. Shëndeti dhe siguria**

Punonjësit e doganës kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambiente të shëndetshme dhe të sigurt. Ata duhet t'i marrin me shumë seriozitet përgjegjësitë që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe duhet t'i raportojnë menjëherë eprorit të drejtpërdrejtë për çdo problem shëndeti dhe sigurie, që mund të lindë nga shkelja e rregullave në fuqi.

#### **12.4. Drogat**

Dogana është ngarkuar të parandalojë importin e paligjshëm të drogës, për rrjedhojë për të është e papranueshme që një punonjës i saj të merret me import të paligjshëm të saj ose të substancave të tjera të ndaluara, t'i posedojë ato, t'i tregtojë ose t'i konsumojë. Çdo vepër e kësaj natyre që ka lidhje me drogat e paligjshme është objekt i ndjekjeve disiplinore, ose penale, ose i të dyjave njëkohësisht.

#### **12.5. Alkooli**

Konsumi i pijeve alkoolike nuk duhet t'i pengojë punonjësit në kryerjen e detyrave të tyre. Kur konsumi i këtyre pijeve influencën në cilësinë e punës ose në sjelljen e punonjësit, ai duhet të pezullohet nga çdo lloj aktiviteti profesional deri sa të rifitojë të gjitha aftësitë e tij. Duke pasur parasysh se alkooli shpesh është shkaku i aksidenteve në vendin e punës, punonjësit që hipin në anije, që drejtojnë automjete ose që vënë në funksionim makineri, duhet të ndalojnë konsumimin e çdo lloj pije alkoolike që para marrjes së detyrës.

#### **12.6. Duhani**

Dogana e ka për detyrë të mbrojë punonjësit e saj, si dhe të kujdeset që gjithsecili të ushtrojë veprimtarinë e tij në ambjent të shëndetshëm dhe të sigurtë. Për pasojë punonjësit nuk duhet të pinë duhan në zona ku duhani është i ndaluar ose kur kryen aktivitetin e tij në ambiente publike dhe të respektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

#### **12.7. Rregullat e veshjes dhe paraqitjes së jashtme**

Veshja dhe prezantimi i punonjësit duhet të japë një përshtypje serioze.

Paraqitja e punonjësit mund të influencojë mbi idenë që publiku krijon për doganën, si dhe për mënyrën se si ajo plotëson detyrat e saj. Veshja duhet të jetë në raport me funksionet që kryen dhe duhet të respektohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në këtë fushë. Doganieri duhet të ketë një veshje të pastër dhe të rregullt.

Ka shumë rëndësi që stafi i doganierëve që janë me uniformë të tregojë një paraqitje serioze. Mbajtja e uniformës duhet të përputhet me instruksionet e dhëna për këtë qëllim. Doganieri duhet të kujdeset që uniformën ta ketë të pastër dhe të rregullt. Çdo riparim ose modifikim i nevojshëm duhet të kryhet për një kohë sa më të shpejtë.

### **13. Përmbledhje**

Publiku kërkon që çdo punonjës dogane të jetë i ndershëm, i paanshëm i aftë profesionalisht. Me qëllim që të ruhet besimi i publikut, ka shumë rëndësi që punonjësi i doganës të zbatojë në mënyrë shumë rigoroz rregullat e etikës kur ai kontakton me publikun, me ndërmarrjet ose me punonjësit e tjerë të shtetit.

Respektimi i plotë i rregullave të etikës kërkon që çdo punonjës i doganës duhet:

- Të përmbushë funksionet e tij me kujdes, seriozitet dhe mirësjellje;
- Të përpiqet të zbatojë me maksimumin e seriozitetit rregullat e etikës duke mos u mjaftuar me respektimin minimal të tyre;
- Të sillet në vazhdimësi në një mënyrë të tillë që të ruajë ose të përmirësojë imazhin e doganës;

Në veçanti drejtuesit kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur. Ata duhet të jenë të gatshëm që:

- Të japin shembullin personal;
- Të kujdesen që personeli të njohë ligjet, udhëzimet, procedurat e Administratës Doganore;
- Të marrin të gjitha masat e nevojshme kur personeli i tyre nuk zbaton rregullat në fuqi;

#### **14. Shkeljet**

Shkelja e rregullave të mësipërme përbëjnë shkak për fillimin e procedurave disiplinore dhe marrjen e masave sipas përcaktimeve në legjislacionin për nëpunësin civil.